

K O N T R A T E S H I T J E E
KUOTAVE TE KAPITALIT TE
SHOQERISE TREGTARE

BAZA LIGJORE NENI 705 E VIJIM I KODIT CIVIL, LIGJI 9901 DATE 14.04.2008
PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE

Sot ne 28/09/2022, (dymije e njezetedy), ne Korce lidhet kjo kontrate ne kushtet dhe afatet si me poshte

Ortaku :

Z. Vasjan Koleci, shtetas shqiptar, lindur me 18.08.1981, ne Korçe, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes/ leternjofimit me numer personal I10818035A, me zotesi te plote per te vepruar qe ketu e me poshte per efekt te kesaj kontrate do te quhet Shitesi

Bleresi:

Shoqeria "G.J. Group sh.p.k", me Nr.NIPT L24804001E, me adresë ne Korçë, Rruga Perlat Rexhepi nr. 6, perfaqesuar nga Administratori **Ledja Mullaj**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me numer identifikues J75323068D qe ketu e me poshte per efekt te kesaj kontrate do te quhet Bleresi

Personat e mesiperme jane madhore, me zotesi te plote per te vepruar, me identitetin e dhene nga dokumentet identifikuese qe ata mbajne.

Palet kontraktuese kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitje bazuar ne nenin 705 e vijim te K. Civil si dhe ne dispozitat e ligjit 9901 dhe statutit te shoqerise tregtare Bellevedere Korça Sh.p.k, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi M04216001A.

Duke qene se :

Shoqeria tregtare Bellevedere Korça Sh.p.k, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi M04216001A ka nje kapital themeltar ne lek ne masen 100 lek. Secili ortak ka sjelle kontribute ne lek ne masen 50 lek .

Shitesi eshte pronar i nje kuote. (Kuota) ka nje vlere prej 50 lek dhe perfaqeson 50% (pesedhjete perdind) te kapitalit te regjistruar te shoqerisë Bellevedere Korça themeluar sipas legjislacionit shqiptar në 02/06/2020, me numër NUIS M04216001A dhe seli ne adresën: Korçë, Shqiperi (ne vijim referuar si."Shoqeria).

Bleresi deshiron te bleje te gjithë Kuotën e Shitesit që përfaqëson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqerise ("Kuota") dhe Shitesi deshiron te shese tek Bleresi Kuoten sipas kushteve dhe.detyrimeve te percaktuara nepermjet kesaj Kontrate.



Objekti material i kesaj kontrate eshte shitja e pjeses te kuoatave te kapitalit qe zoteron Vasjan Koleci ne masen 50% te zoteruara ne shoqerine tregtare Bellevedere Korça themeluar sipas legjislacionit shqiptar në 02/06/2020, me numër NUIS M04216001A.

Sipas te dhenave ne ekstraktin e shoqerise rezulton se:

Ortaku: **Vasjan Koleci**

Vlera e kapitalit	Para: 50 lek
Numri i pjesëve	1,00
Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00

Blerësi nuk do te mbartë dhe nuk do te ketë asnje pergjegjesi dhe pasojë financiare, ligjore ose penale ne lidhje me cilindo detyrim penalitet, shkelje, parregullesi ose mosperputhje me ligje, akte nenligjore dhe rregullore te cilat mund te rezultojne nga çdo lloj kontrolli ose Inspektimi apo pretendimi i te treteve ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise per periudhen kur Shitesi ka patur pronesine e kuotes se Shoqerise dhe/ose para kesaj periudhe.

Me kalimin e pronesise se kuotes ne pronesis te Bleresit, Bleresi do te zoteroje nje kuote te shoqerise qe perben 50% te kapitalit te regjistruar te saj.

Me konkretisht- behet pronar :

Vlera e kapitalit	Para: 50 lek
Numri i pjesëve	1,00
Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00

ÇMIMI I BLERJES SE KUOTËS, MËNYRA E PAGESËS DHE KALIMI I PRONESISË

Cmimi i kuotes do te paguhet nga bleresi eshte sa vlera nominale e kuotes , konkretisht **50 Lek.**

Bleresi do ti paguaje cmimin e blerjes , shitesit ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Pronesia mbi kuoaten do te kaloje ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate dhe pasi bleresi te kete paguar cmimin e blerjes ne llogari te shitesit.

Likujdimi i shumës që përbën çmimin e shitblerjes së aksioneve të mësipërme nga palët kontraktuese eshte realizuar ndermjet paleve.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate Pronari Vasjan Koleci humbet te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe mund te lindin nga zoterimi i 50% te kuotes ne shoqerine Bellevedere Korça shpk nga momenti i fitimi te tyre dhe deri ne ditën e sotme. Keto te drejta dhe detyrime me kalimin e aksioneve i kalojne Pronarit **G.J. Group sh.p.k**

Palet kontraktore marrin persiper te mos e pengojne ne asnje rast njera tjetren ne permbushjen e detyrimeve te tyre kontraktore, ne te kundert jane pergjegjes per demet dhe mospermbushje kontraktore, ne zbatim te dispozitave te kesaj kontrate dhe te Kodit Civil.

Bashkangjitur kesaj kontrate dhe pjese perberese e saj jane vendimi i asambleses se shoqerise tregtare per miratimin e kalimit te pronesisë dhe ekstrakti i regjistrimit te shoqerise tregtare . Për interpretimin e dispozitave të kësaj kontrate do të merren për bazë dispozitat e Kodit Civil, ligjit 9901 dhe statuti i shoqerise .

Gjithashtu në interpretimin e kontratës do të mbahen parasysh zakonet e mira në mardhëniet kontraktore të kësaj natyre.

Palët angazhohen të zgjidhin me mirkuptim çdo mosmarrveshje që mund të lindë mes tyre ose mes tyre ose të tretëve për interpretimin e dispozitave të kësaj kontrate, apo për shkak të saj.

Në rast se mirkuptimi nuk arrihet kompetente për gjykimin e konflikteve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë Korçe.

Kontrata u perpilua konform neneve 705 e vijues te Kodit Civil.

Kontrata e shitjes u perpilua dhe u hartua në kompjuter, pa korrigjime të asnjëlloj natyre, në 4 kopje të barasvlefshme nga te cilat secila nga palët mori nga një kopje dhe nje kopje do te depozitohen ne QKB ne regjistrin tregtar.

Për sa më sipër palëte nënshkruan kontratën pa verejtje .

PALET

SHITESI

Vasjan Koleci

BLERESI

G.J. Group sh.p.k

Ledja Mullaj



VENDIM

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 28.09.2022, në orën 10:30, selinë e Shoqërisë Bellevedere Korça Sh.p.k, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi M04216001A (më tej referuar si "SHOQËRIA"), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Z. Vasjan Koleci**, shtetas shqiptar, lindur më 18.08.1981, në Korçë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës/ letërnjoftimit me numër personal I10818035A, ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit të saj.
- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034271384-, ortakee Shoqërisë dhe zotërues i 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit.

Z. Vasjan Koleci i cili merr përsipër të kryesojë mbledhjen, pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si vijon:

RENDI I DITËS

- I. Miratimi i transferimit të plotë të kuotës së ortakut Vasjan Koleci në cilësinë e Shitësit tek shoqëria G.J.Group Sh.p.k. në cilësinë e Blerësit;**
- II. Miratimi i nënshkrimit të Kontratës së Shitjes së Kuotës mes palëve të sipërpërmendura;**

Në lidhje me pikën e parë dhe të dytë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se, është paraqitur përpara Asamblesë propozimi i ortakut Vasjan Koleci për shitjen dhe transferimin e kuotës së tij në kapitalin e Shoqërisë tek shoqëria (jo-ortake) G.J. Group Sh.p.k.

Ortaku **Vasjan Koleci** ka marrë paraprakisht edhe miratimin e ortakut tjetër për këtë transferim si edhe heqjen dorë nga ky i fundit nga e drejta e parablerjes së kuotës, sipas parashikimeve të nenit 7 të Statutit të Shoqërisë.

Ortaku tjetër **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k** deklaroi para asamblesë së Shoqërisë se ai ka hequr dorë në mënyrë të parevokueshme dhe pa kushte nga e drejta e parablerjes për Kuotën e ortakut Vasjan Koleci dhe miraton shitjen e saj tek Blerësi G.J. Group Sh.p.k me nr Nipti L24804001E.

Asambleja pasi e shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes propozimin,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e plotë të kuotës që përbën 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, nga ortakut Vasjan Koleci, në cilësinë e Shitësit tek shoqëria G.J. Group Sh.p.k me nr Nipti L24804001E në cilësinë e Blerësit.
2. Të miratojë nënshkrimin e Kontratës së Shitjes së Kuotës mes ortakut Vasjan Koleci në cilësinë e Shitësit dhe shoqërisë G.J. Group Sh.p.k me NIPT L24804001E në cilësinë e Blerësit, sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara paraprakisht mes palëve.
3. Me ekzekutimin e Kontrates se Shitjes ndërmjet Vasjan Koleci në cilësinë e Shitësit dhe shoqërisë G.J. Group Sh.p.k me NIPT L24804001E në cilësinë e Blerësit, kapitali i Shoqërisë do te përbehet nga dy kuota qe i caktojnë te drejta pjesëmarrjeje ortakeve si ne vijim: 50% ne favor te G.J. Group Sh.p.k dhe 50% ne favor te Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.

Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE:

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k

Z.Vasjan Koleci



Edlira Muka





